

## Të ushqyerit me objektiva të qarta në periudhën e tharjes

*Përmbledhje nga një referat i Schaumann në Konferencën e Mbarështimit të Gjedhit në shtator 2013 në Austri, nga Olger Nanagjoka – Përfaqësuesi i shitjeve të Austria Prämix shpk.*

**Në fazën e parë** të periudhës së tharjes, tetë deri në katër javë përpara pjelljes, duhet që lopët të ushqehen me racione të pasura me celulozë.

Nëse është në dispozicion vetëm silazh bari, duhet që të shtohen minimalisht 2 deri në 3 kg ushqim me sanë të thatë dhe kashtë. Furnizimi me energji nuk duhet të tejkalojë në asnjë rast 50 MJ NEL, e cila korrespondon me kërkesat për energji për mirëmbajtjen dhe 5-6 litra qumështit. Në fazën e parë të tharjes, silazhi i misrit duhet të reduktohet ose të mos përdoret fare. Vetëm në fazën e dytë të ashtuquajturën „Faza e Tranzicionit“, tre javë



para pjelljes, për shkak të nevojave në rritje të fetusit dhe rritjes në kohë të funksionalitetit të indit villor të Rumenit, është i nevojshëm përdorimi i koncentreve të pasura me energji duke filluar me 0,5 kg gradualisht me 2 deri max. 3 kg. Në këtë fazë tranzitore rumeni përgatitet për performancën e ardhshme të tretjes së racionit. Problemi kryesor është se ndryshimet hormonale drejt fundit të shtatëzansë dhe të fetusit në zhvillim çojnë në një rënie në konsumin e ushqimit deri në 30%, ndërkohë kërkesa për lëndët ushqyese rritet. Për këtë arsye, në javët e fundit para

pjelljes është e rëndësishme jo vetëm përdorimi i koncentrateve të duhura por edhe cilësia e lartë e ushqimeve voluminoze.

## **Rritje e ngadaltë**

Rritja e dhënies së koncentratit në fillim të laktacionit mbahet nën vëzhgim të vazhdueshëm duke u kujdesur për konsumin e ushqimit voluminoz (sjellja e të ushqyerit) për shkak të rrezikut të acidosisë së rumenit. Në varësi të pritshmërive të rendimentit pas një jave duhet t'u jepet max. 4 kg deri në 5 kg ushqim i koncentruar, pas dy javësh rreth 5 kg deri në 6 kg dhe në javën e katërt max. 6 kg deri në 8 kg. Vetëm me teknikën e duhur të ushqyerit në javën e katërt mund të jepet një sasi e arsyeshme maksimale prej 8 kg në ditë deri në tejkalimin e prodhimitarisë së qumështit ose tejkalim në raste individuale.

Në laktacionin në vijim, të ushqyerit me koncentratë bazohet mbi kërkesat e rendimentit. Racionet me përqindje të lartë koncentratit diktojnë kërkesa të larta përbërjeje. Është e dobishme që tek racionet me sasi të lartë drithërash një pjesë të zëvendësohet me misër dhe panxhar të presuar, pasi këto janë me të qëndrueshme në rumen se sa drithërat dhe si pasojë reduktojnë rënien e pH (rrezikun e acidosisë) dhe nuk ndikojnë në konsumin e ushqimit.

## **Defiçiti i energjisë – i pashmangshëm!**

Pjesa më e vështirë është periudha e fillimit të ri-mjelljes, veçanërisht kur lopa jep më shumë se 30 kg qumësht. Në javët e para të laktacionit lopët kanë gjithmonë defiçit energjie, pasi konsumi i ushqimit direkt para pjelljes është nën nevojat e organizmit dhe pas pjelljes rritet gradualisht. Një bilanc negativ energjie për një periudhë të gjatë privon lopën nga një barrësmëri e re. Pasojat janë mungesa hormonale dhe krijimi i cisteve ovariane. Nëse lopa detyrohet të humbasë yndyrnat trupore, kjo gjë çon në shpërbërje jo të plotë të yndyrës trupore, sepse lopës i mungon burimi i energjisë për një humbje të plotë yndyre (përkatësisht glukozë për sintezën e acidit oksaloacetik), gjë që është parakusht për një shpërbërje të plotë të yndyrave në acidet yndyrore. Kjo shkakton një rritje të masave yndyrore (trupat Ketone), të cilat nuk mund të shfrytëzohen plotësisht. Për këtë arsye „Ketoza“ ose „Acetonaemia“ konsiderohet sëmundje e lopëve me rendiment të lartë. Po ashtu një mungesë e celulozës së mirëstruktuar ose silazheve që përmbajnë acid butirik nxisin

dukurinë e ketozës. Ushqimi i mirëstrukturuar është më i rëndësishëm se furnizimi me energji nëpërmjet mbidozave me racion koncentratësh (rrezik për aciditetin e rumenit).

**Faza kritike** e shpërbërjes së yndyrave trupore fillon jo shumë vonë pas pjelljes dhe në këtë mënyrë përkon pikërisht me periudhën kur lopa duhet të mbarset. Humbja e substancave trupore kontribuon natyrshëm për një mos-stabilitet shëndetësor dhe në simptomat e afshit. Shumë fermerë janë të vetëdijshëm për këtë problem dhe kanë tendencën për të ulur sa më shpejt të jetë e mundur „periudhën e pushimit biologjik“ duke tentuar menjëherë inseminimin dhe barrësmëri të suksesshme. Si rezultat i rigjenerimit jo të plotë të mitrës (rreth 6-8 javë pas pjelljes) është i pranishëm rreziku i infektimit të mitrës ose ngordhja e fetusit.

Në parim lopa nuk duhet të mbarset para ovulacionit të tretë, i cili ndodh më së shumti ndërmjet ditës së 50-të e të 56-të pas pjelljes. Maksimumi pas ditës së 90-të lopa duhet të mbarset sërish, në të kundërt do të jetë shumë e vështirë të ketë një barrësmëri të suksesshme.

## **Faza e 2-të dhe 3-të e laktacionit**

Në fazën e dytë të laktacionit, ndërmjet muajit të tretë dhe të gjashtë të laktacionit, konsumi i ushqimit është kryesisht në raport të drejtë me prodhimin e qumështit dhe bilancin e energjisë. Të rëndësishme në këtë aspekt janë racionime ushqimi voluminoz edhe dhënia në sasinë e duhur të koncentratës. Në fermat që përdorin programe kompjuterike të të ushqyerit, përshtatja optimale e koncentratës bëhet me anë të kompjuterit.

Më e vështirë është të ushqyerit në fazën e fundit të laktacionit. Duhet të theksohet se konsumi me ushqime voluminoze e cilësore është shpesh më i lartë se kërkesa mbi bazën e prodhimit të qumështit. Rreziku për një dhjamosje graduale është shumë i lartë. Sasia e koncentratës duhet reduktuar gradualisht në bazë të prodhimtarisë, madje me ushqim voluminoz të cilësisë së lartë dhe aplikim të silazhit të misrit, derisa të ndërpritet plotësisht. Në këtë aspekt dhjamosja e lopëve me të gjitha pasojat mund të konstatohet zakonisht me vonësë.

Mbiushqyerja në fazën e fundit të laktacionit si dhe një reduktim i menjëhershëm i lëndëve ushqyese para periudhës së tharjes mund të çojë në çrregullime metabolike para pjelljes.